

**PROCESVERBAL**  
**nga seanca e 6-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime**  
**Mediatike Audio dhe Audiovizuale**  
**mbajtur më 19.02.2024**

**Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë nëpërmjet lidhjes video-konferencë:** Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançecki, L Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

**Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /**

**Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë, ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.**

**Të pranishmit nga Shërbimi Profesional nëpërmjet lidhjes video-konferencë:** mr. Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, mr. Magdalena Davidovska Dovleva, Goran Radunoviq, Maja Damevska, mr. Ruzhica Boshnakoska Jotevska, dr. Ivana Stojanovska.

**Të pranishmit e tjerë : /**

Z. Petrushevski hapi seancën e 6-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në ora 14:00 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Z. Petrushevski informon se pika nr. 2 përmban 12 propozime për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes për transmetim televiziv dhe radio të radiodifuzerëve. Ai shpjegoi se SHTR TV ERA SHPKNJP Shkup e ka paguar kompensimin dhe ajo pikë do të tërhiqet nga rendi i ditës, por në vend të saj do të shtohet propozimi për SHTR RADIO USKANA-PLUS eksport-import SHPKNJP Kërçovë për shkak se nuk ka paguar kompensimin vjetor për lejen, për të cilën materiali u është dorëzuar anëtarëve të Këshillit.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, me 6 vota "pro", miratoi:

**RENDIN E DITËS**

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 5- e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 07.02.2024.
2. Propozimet për iniciimin e procedurave për heqjen e lejes për TV dhe radio të radiodifuzerëve.
3. Propozim për shqiptimin e masës ndaj operatorit Multimedija Network nga Gostivari për shkelje të nenit 141 të LSHMAAV.
4. Propozim për shqiptimin e masës ndaj operatorit Telenet Kom nga Tetova për shkelje të nenit 141 të LSHMAAV.
5. Propozim për shqiptimin e masës ndaj operatorit Infel-KTV nga Ohri për shkelje të nenit 141 të LSHMAAV.

6. Propozim-vendim për pezullimin e marëdhënies së punës të punonjësit në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.
7. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: Kontrolle sistematike.
8. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: Mirëmbajtja parandaluese dhe adaptive e softuerit të integruar për punë juridike, financiare dhe ekonomike
9. Të ndryshme.

### **Pika 1**

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e propozuar të seancës së 5- të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 07.02.2024, me tekstin e propozuar.

### **Pika 2**

Z. Petrushevski, në lidhje me 12 propozimet për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes për transmetim televiziv dhe radio të radiodifuzerëve, propozoi që të bëhet prezantim dhe diskutim i përbashkët dhe votomi të jetë individual për secilin propozim të përmendur.

Këshilli nuk kishte kundërshtim.

Z. Trajçevski sqaroi se të gjithë transmetuesit në fjalë nuk e kanë paguar kompensimin vjetor në afatin e përcaktuar Ligjor. Njëri prej tyre, Shoqëria Tregtare Radiodifuzive RADIO ALEKSANDAR MAKEDONSKI Ilija Tanevski Kërçovë SHPKNJP, e kishte paguar kompensimin por si person fizik dhe meqënëse Ligji është ndryshuar mjetet i janë kthyer dhe do të duhet t'i paguajë përsëri, por nga llogaria e radiodifuzerit. Për këtë arsye propozohet fillimi i procedurave për heqjen e lejes.

Z. Petrushevski propozoi që Shërbimi pas përfundimit të seancës t'i informojë me kohë transmetuesit për afatin deri në të cilin duhet të paguajnë mjetet, në mënyrë që të mos vonohen dhe të mos u hiqet leja.

- Këshilli i Agjencisë njëzëri ka nisur procedurën për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV-EDO SHPKNJP fsh.Ljubin, Sara, PA1 nr. 08-14, datë 07.09.2023, për shkak të mospërmbushjes së detyrimit nga neni 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, gjegjësisht nuk ka paguar kompensimin vjetor për lejen e transmetimit televiziv Agjencisë për Shërbimet Mediatike Audio dhe Audiovizuele sipas faturës së dorëzuar me nr.2024-100-0008 datë 11.01.2024 .

Nëse transmetuesi i lartpërmendur nuk paguan kompensimin vjetor për lejen e transmetimit televiziv, Këshilli i Agjencisë, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së Propozimit për fillimin e procedurës për heqjen e lejes, do të marrë Vendim për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV-EDO SHPKNJP fsh.Ljubin, Saraj, PA1 nr.08-14, datë 07.09.2023, për shkak të shkeljes së nenit 80 paragrafi (5) të LSHMAAV.

- Këshilli i Agjencisë njëzëri inicioi procedurë për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO USKANA-PLUS eksport-import SHPKNJP Kërçovë, PA1 nr. 08-105 datë 07.09.2023, për shkak të mospërbushjes së detyrimit nga neni 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, gjegjësisht nuk ka paguar kompensimin vjetor për lejen e transmetimit në radio Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale sipas faturës së dorëzuar nr.2024-100-0058 datë 11.01.2024.

Nëse transmetuesi i lartpërmendur nuk e paguan kompensimin vjetor për lejen e transmetimit në radio, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes, do të marrë Vendim për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare për Radiodifuzion RADIO USKANA-PLUS eksport-import SHPKNJP Kërçovë, PA1 nr.08-105, datë 07.09.2023, për shkak të shkeljes së nenit 80 paragrafi (5) të LSHMAAV.

- Këshilli i Agjencisë njëzëri ka iniciuar procedurë për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup, PA1 nr.08-18 nga 07.09.2023, për shkak të mos përbushjes së detyrimit nga neni 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, gjegjësisht nuk ka paguar kompensimin vjetor për lejen e transmetimit televiziv Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale sipas faturës së dorëzuar nr.2024-100-0011 datë 11.01.2024.

Nëse transmetuesi i lartpërmendur nuk e paguan kompensimin vjetor për lejen e transmetimit televiziv, Këshilli i Agjencisë, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes, do të marrë Vendim për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup, PA1 nr.08-18 datë 07.09.2023, për shkelje të nenit 80 paragrafi (5) të LSHMAAV.

- Këshilli i Agjencisë njëzëri ka iniciuar procedurë për heqje të lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TELEVISIONI KOÇAN-LD SHPKNJP Koçan, PA1, nr.08-44, datë 07.09.2023, për shkak të mospërbushjes së detyrimit nga neni 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, gjegjësisht nuk ka paguar kompensimin vjetor për lejen e transmetimit televiziv Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale sipas faturës së dorëzuar nr.2024-100-0014 datë 11.01.2024.

Nëse transmetuesi i lartpërmendur nuk e paguan kompensimin vjetor për lejen e transmetimit televiziv, Këshilli i Agjencisë, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes, do të marrë Vendim për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TELEVISIONI KOÇAN-LD SHPKNJP Koçan, PA1 nr.08-44, datë 07.09.2023, për shkelje të nenit 80 paragrafi (5) të LSHMAAV.

- Këshilli i Agjencisë njëzëri ka nisur procedurë për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive T.V. KALTRINA Mazar Tateshi, Strugë SHPKNJP, PA1 nr.08-55, datë 07.09.2023, për shkak të mospërbushjes së detyrimit nga neni 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive, gjegjësisht nuk ka paguar kompensimin vjetor për transmetim televiziv Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale sipas faturës së dorëzuar nr.2024-100-0018, datë 11.01.2024.

Nëse transmetuesi i lartpërmendur nuk paguan kompensimin vjetor për lejen e transmetimit televiziv, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes, do të marrë Vendim për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive T.VC. KALTRINA Mazar Tateshi, Strugë SHPKNJP PA1 nr. 08-55, datë 07.09.2023, për shkelje të nenit 80 paragrafi (5) të LSHMAAV.

- Këshilli i Agjencisë njëzëri ka inicuar procedurë për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RFM SHPKNJP Shkup, PA1 nr.08-75 datë 07.09.2023, për mospërbushje të detyrimit nga neni 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, përkatësisht nuk ka paguar kompensimin vjetor për lejen e transmetimit në radio Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale sipas faturës së dorëzuar nr.2024-100-0035 të datës 11.01.2024.

Nëse transmetuesi i lartpërmendur nuk paguan kompensimin vjetor për lejen e transmetimit televiziv, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes, do të marrë Vendim për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive T.V. KALTRINA Mayar Tateshi, Strugë SHPKNJP PA1 nr.08-55 datë 07.09.2023, për shkelje të nenit 80 paragrafi (5) të LSHMAAV.

- Këshilli i Agjencisë njëzëri inicioi procedurë për heqjen e lejes të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RFM SHPKNJP Shkup, PA1 nr.08-78 datë 07.09.2023, për shkak të mospërbushjes së detyrimit nga neni 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, gjegjësisht nuk ka paguar kompensimin vjetor për lejen e transmetimit në radio Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale sipas faturës së dorëzuar nr.2024-100-0038 datë 11.01.2024.

Nëse transmetuesi i lartpërmendur nuk e paguan kompensimin vjetor për lejen e transmetimitit në radio, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes, do të marrë Vendim për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RFM SHPKNJP Shkup, PA1 nr.08-78 datë 07.09.2023, për shkelje të nenit 80 paragrafi (5) të LSHMAAV.

- Këshilli i Agjencisë njëzëri inicioi procedurë për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO HIT FM SHPKNJP Shkup, PA1 nr.08-90 datë 07.09.2023, për shkak të mospërbushjes së detyrimit nga neni 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, gjegjësisht nuk ka paguar kompensimin vjetor për lejen për transmetim në radio të Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale sipas faturës së dorëzuar nr.2024-100-0046 datë 11.01.2024.

Nëse transmetuesi i lartpërmendur nuk paguan kompensimin vjetor për lejen e transmetimit në radio, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes, do të marrë Vendim për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO HIT FM SHPKNJP Shkup, PA1.08-78 datë 07.09.2023, për shkelje të nenit 80 paragrafi (5) të LSHMAAV.

- Këshilli i Agjencisë njëzëri ka iniciuar procedurë për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO VALANDOVO SHPK Vallandovë, PA1 nr.08-90 datë 07.09.2023, për mos përmbushje të detyrimit nga neni 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, gjegjësisht nuk ka kompensimin

vjetor për lejen e transmetimit në radio Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, sipas faturës së dorëzuar nr. 2024-100-0046 datë 11.01.2024.

Nëse transmetuesi i lartpërmendur nuk e paguan kompensimin vjetor për transmetim në radio, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes, do të marrë Vendim për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO VALLANDOVË SHPK Vallandovë, PA1 nr.08-90 datë 07.09.2023, për shkelje të nenit 80 paragrafi (5) të LSHMAAV.

- Këshilli i Agjencisë njëzëri ka inicuar procedure për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive GALAKSI - 2002 SHPKNJP Kavadar, PA1 nr. 08-100 datë 07.09.2023, për shkak të mospërbushjes së detyrimit nga neni. 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, gjegjësisht nuk ka paguar kompensimin vjetor për lejen e transmetimit në radio Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale sipas faturës së dorëzuar nr.2024-100-0053 datë 11.01.2024.

Nëse transmetuesi i lartpërmendur nuk e paguan kompensimin vjetor për lejen e transmetimit në radio, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes, do të marrë Vendim për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive GALAKSI – 2002 SHPKNJP Kavadar, PA1 nr. 08-100, datë 07.09.2023, për shkelje të 80 paragrafi (5) të LSHMAAV.

- Këshilli i Agjencisë njëzëri ka inicuar procedurë për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO ALAKSANDAR MAKEDONSKI Ilija Tanevski SHPKNJP, PA1 nr.08-102 datë 07.09.2023, për shkak të mospërbushjes së detyrimit nga neni 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, gjegjësisht nuk ka paguar kompensimin vjetor për lejen e transmetimit në radio Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale sipas faturës së dorëzuar nr.2024-100-0055 datë 11.01.2024.

Nëse transmetuesi i lartpërmendur nuk e paguan kompensimin vjetor për lejen e transmetimit në radio, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes, do të marrë Vendim për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO ALEKSANDAR MAKEDONSKI Ilija Tanevski Kërçovë SHPKNJP, PA1 nr.08-102 datë 07.09.2023, për shkak të shkeljes së nenit 80 paragrafi (5) të LSHMAAV.

- Këshilli i Agjencisë njëzëri ka inicuar procedurë për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive HIT RADIO SHPKNJP Strumicë, PA1 1 nr.08-128, datë 07.09.2023, për shkak të mospërbushjes së detyrimit nga neni 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, gjegjësisht nuk ka paguar kompensimin vjetor për lejen e transmetimit në radio Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale sipas faturës së dorëzuar nr. 2024-100-0071 datë 11.01.2024.

Nëse transmetuesi i lartpërmendur nuk e paguan kompensimin vjetor për lejen e transmetimit në radio, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes, do të marrë Vendim për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive HIT RADIO SHPKNJP Strumicë, PA1 nr.08-128, datë 07.09.2023, për shkelje të nenit 80 paragrafi (5) të LSHMAAV.

- Këshilli i Agjencisë njëzëri ka iniciuar procedurë për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Tregtare RADIO RED FM SHPKNJP Tetovë, PA1 nr.08-133 datë 07.09.2023, për shkak të mos përmbushjes së detyrimit nga neni 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, gjegjësisht nuk ka paguar kompensimin vjetor për lejen e transmetimit në radio Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale sipas faturës së dorëzuar nr.2024-100-0076 e datës 11.01.2024.

Nëse transmetuesi i lartpërmendur nuk e paguan kompensimin vjetor për lejen e transmetimit në radio, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes, do të marrë Vendim për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO RED FM SHPKNJP Tetovë, PA1 nr.08-133, datë 07.09.2023, për shkelje të nenit 80 paragrafi (5) të LSHMAAV.

### **Pikat 3, 4 dhe 5**

Z. Trajçeovski shpjegoi se për të tri pikat do të bëjë një hyrje të përbashkët sepse bëhet fjalë për shkelje të njëjtë të nenit 141 të LSHMAAV, gjegjësisht tek të tre të tre operatorët kabllorë është konstatuar se ritransmetojnë shërbim programor pa rregulluar të drejtën autoriale, gjegjësisht shërbim programor që nuk mbulohet me certifikatën për regjistrim të dhënë nga Agjencia. Tek operatorët Multimedija Network nga Gostivari dhe Telenet Kom nga Tetova është konstatuar se ritransmetojnë të njëjtin shërbim programor " Eurosport 2 ", ndërsa Infel-KTV nga Ohri është duke ritransmetuar shërbimin programor " Da Vinci ". Për të tre operatorët propozohet masë vërejtjeje publike dhe urdhërohen që menjëherë të ndalojnë me ritransmetim dhe më pas do të kryhet mbikëqyrje kontrolli për të parë nëse kanë vepruar sipas aktvendimit për shqiptimin e masës vërejtje publike.

### *Votimi për pikën 3*

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer të rregullt programore, nr.1102-744/1 të datës 15.02.2024 dhe njëzëri konstatoi që Shoqëria për prodhim, tregti, hotelieri, trafik dhe shërbime MULTIMEDIJA NETWORK L SHPKNJP eksport-import Gostivar t'i shqipton masë vërejtje publike për shkelje të nenit 141 të LSHMAAV dhe në pajtim me pikën 8 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar) nr.01-4139/1 të datës 07.11.2022 urdhëroi menjëherë pas pranimit të aktvendimit për vërejtje publike që të harmonizojë punën e saj me LSHMAAV.

Me mbikëqyrje është konstatuar se Shoqëria për prodhim, tregti, hotelieri, trafik dhe shërbime MULTIMEDIA NETWORK L SHPKNJP eksport-import Gostivar, e cila sipas njoftimit nga Agjencia për Komunikime Elektronike mund të kryej veprimtari në territorin e komunës së Gostivarit, Vrapçishtit të Bogovinës dhe Kërçovës, me datë 13.02.2024, për shfrytëzuesit e tij ka ritransmetuar shërbimin programor " Eurosport 2 " i cili nuk mbulohet me certifikatën për regjistrimin e shërbimeve programore të dhënë nga Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, që është në kundërshtim me nenin 141 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Sektor i për Çështje Juridike duhet të hartojë Akvendimin për shqiptimin e masës vërejtje publike operatorit në fjalë.

Sektor i për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit pas skadimit të afatit të përcaktuar në Akvendimin për vërejtje publike të kryej mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (operatori) ka vepruar sipas masës së shqiptuar.

Sektor i për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e mësipërm duhet ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

#### Votimi për pikën 4

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt programore, nr.1102-742/1 të datës 15.02.2024 dhe njëzëri konstatoi që Shoqërisë për prodhim, tregti dhe shërbime TELENET KOM SHPK eksport-import Tetovë t'i shqiptojë masë vërejtje publike për shkelje të nenit 141 të LSHMAAV dhe në përputhje me pikën 8 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i Pastruar) nr.01-4139/1 datë 07.11.2022 e ka udhëzuar që menjëherë pas pranimit të Aktvendimit për vërejtje publike të harmonizon punën e saj me LSHMAAV.

Me mbikëqyrje është konstatuar se Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime TELENET KOM SHPK eksport-import Tetovë, e cila sipas njoftimit nga Agjencia për Komunikime Elektronike mund të kryej veprimtari në territorin e komunës së Tetovës, me datë 13.02.2024 për shfrytëzuesit e tij ka ritransmetuar shërbimin programor " Eurosport 2 " i cili nuk mbulohet me çertifikatë për regjistrimin e shërbimeve programore të dhënë nga Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, që është në kundërshtim të nenit 141 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Sektor i për Çështje Juridike duhet të hartojë Akvendimin për shqiptimin e masës vërejtje publike operatorit në fjalë.

Sektor i për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit pas skadimit të afatit të përcaktuar në Akvendimin për vërejtje publike, të kryej mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (operatori) ka vepruar sipas masës së shqiptuar.

Sektor i për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, aktvendimin e mësipërm duhet ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

#### Votimi sipas pikës 5

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer të rregullt programore, nr.1102-743/1 të datës 15.02.2024 dhe njëzëri konstatoi që Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive-operator i rrjetit kabllor INFEL-KTV Ohër SHPK t'i shqipton masë vërejtje publike për shkelje të nenit 141 të LSHMAAV dhe në përputhje me pikën 8 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar) nr. 01-4139/1 datë 07.11.2022 e urdhëroi menjëherë pas pranimit të Aktvendimit për vërejtje publike të harmonizon punën e tij me LSHMAAV.

Nga mbikëqyrja është konstatuar se Shoqëria Tregtare Radiodifuzive-operator i rrjetit kabllor INFEL-KTV Ohër SHPK, e cila sipas njoftimit nga Agjencia për Komunikime Elektronike mund të kryej veprimtari në territorin e komunës së Ohrit, me datë 14.02.2024 për

shfrytëzuesit e tij ka ritransmetuar shërbimin programor " Da Vinci ", i cili nuk mbulohet me çertifikatë për regjistrimin e shërbimeve programore të dhënë nga Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, e cila është në kundërshtim me nenin 141 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Spektori për Çështje Juridike duhet të hartojë Aktvendimin për shqiptimin e masës vërejtje publike operatorit në fjalë.

Spektori për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike, të kryej mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (operatori) ka vepruar sipas masës së shqiptuar.

Spektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, aktvendimin e mësipërm duhet ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

## **Pika 6**

Udhëheqësja e Sektorit për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, mr. Dragica Ljubevska - shefe e kabinetit, shpjegoi Propozim-vendimin për pezullimin e marrëdhënies së punës të punonjësit në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Ajo shpjegoi se i punësuar ka kërkuar leje pa pagesë për arsye personale urgjente dhe kjo leje(mungesë) filloi nga 2 dhjetor 2023 deri më 1 mars 2024. Por, i punësuar më 15 shkurt të këtij viti, e ka njoftuar Agjencinë në mënyrë elektronike se nuk do ta vazhdojë marrëdhënien e punës. Zgjedhjet tashmë janë shpallur dhe sipas Kodit Zgjedhor kjo marrëdhënie pune duhet të pezullohet sepse siç thuhet në institucionet shtetërore dhe publike nga shpallja e zgjedhjeve deri në përfundim, në këtë rast të zgjedhjeve presidenciale dhe parlamentare, ndërprerja e marrëdhënies së punës duhet të pezullohet.

Z. Petrushevski u pajtua me arsyetimin dhe tha se ka njoftim dhe në faqen e Agjencisë të Administratës se të gjitha procedurat për punësim janë pezulluar nga 15.02.2024 dhe e njëjta vlen edhe për dorëheqjet.

Këshilli i Agjencisë njëzëri ka miratuar Vendim për pezullimin e marrëdhënies së punës në pajtim me Marrëveshjen për Punësim të të punësuarit në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, për periudhën prej datës 02.03.2024 deri në përfundimin e zgjedhjes së kryetarit të RMV-së, deputetëve në Kuvendin e RMV-së dhe zgjedhjen e Qeverisë së RMV-së në vitin 2024, në përputhje me rezultatet e zgjedhjeve të shpallura me Vendimin për shpalljen e zgjedhjeve për kryetar të RMV-së me nr.ark.09-1168/1 dhe Vendimin për shpalljen e zgjedhjeve për deputetë në Kuvendin e RMV-së me nr.ark.09-1169/1, të dyjat nga 14.02.2024. ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.37/24), për shkak të pamundësisë ligjore për zbatim të procedurës për ndërprerje të marrëdhënies së punës, gjegjësisht anulim të marrëveshjes për punësim me aneks, me rastin e deklaratës së punëmarrësit për anulim të Marrëveshjes së Punës.

## **Pika 7**

Udhëheqësja e Sektorit për Çështje Juridike dhe Furnizim Publik, Cvetanka Mitrevska shpjegoi Propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: Kontrolle sistematike. Ajo ka shpjeguar se në përputhje me dispozitat e Ligjit për siguri dhe shëndet në punë është e nevojshme të kryhen kontrolle sistematike për të



punësuarit e Agjencisë me qëllim të veprimit parandalues dhe ruajtjes së shëndetit të tyre. Në pajtim me vlerën e parashikuar, ky furnizim publik do të realizohet si furnizim me vlerë të ulët, në përputhje me të gjitha dispozitat që zbatohen për këtë procedurë. Ajo deklaroi se për informacion më të detajuar ka në materialet nën artikull.

Këshilli i Agjencisë miratoi njëzëri zbatimin e procedurës për furnizim publik-shërbim: Kontrolle sistematike.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën: Kontrolle sistematike, është parashikuar dhe është në përputhje me Planin vjetor për furnizime publike për vitin 2024 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale nr.05-4729/1 datë 22.12.2023 dhe mjetet janë siguruar nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2024.

### **Pika 8**

Udhëheqësja e Sektorit për Çështje Juridike dhe Furnizim Publik, Cvetanka Mitrevska shpjegoi Propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik. - shërbim: Mirëmbajtja parandaluese dhe adaptive e softuerit të integruar për punë juridike, financiare dhe ekonomike. Ajo shpjegoi se ky furnizim bëhet përmes një procedure të specializuar për furnizim, dhe kjo është procedurë me marrëveshje, pa shpallje njoftimi, për mbrojtjen e të drejtave ekskluzive, përfshirë dhe të drejtat e pronësisë intelektuale. Furnizimi kryhet me qëllim të sigurimit të funksionimit normal të softuerit që është marrë nga Agjencia në periudhën e kaluar dhe do të fillojë me miratim nga Byroja për furnizim publik në lidhje me këtë janë plotësuar kushtet për zbatimin e mëtejshëm të procedurës për marrëveshje (negociata) pa publikim të njoftimit.

Këshilli i Agjencisë njëzëri dha miratimin për zbatimin e procedurës për furnizim publik-shërbim: Mirëmbajtja parandaluese dhe adaptive e softuerit të integruar për punë juridike, financiare dhe ekonomike.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën: Mirëmbajtje parandaluese dhe adaptive e softuerit të integruar për punë juridike, financiare dhe ekonomike, është parashikuar dhe është në përputhje me Planin vjetor për furnizim publik për vitin 2024 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale nr.05-4729/1 nga data 22.12.2023, ndërsa mjetet janë siguruar nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2024.

### **Pika 9**

#### **Të ndryshme**

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale  
Kryetari i Këshillit ,  
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

